

EPPC Albania kërkon një **Drejtues të Departamentit Mekanik** për klientin e saj, një kompani prestigjioze shqiptare, e cila operon në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës.

Përgjegjësitë kryesore:

- Organizon dhe bashkërendon punën në department, me njësitë e shërbimeve, si dhe me departamentet e tjera të shoqërisë, për arritjen me efikasitet të lartë të qëllimit të përshkruar më sipër;
- Zhvillon dhe propozon procedura për mirëadministrimin e flotës së mjeteve, monitorimin, mirëmbajtjen, si dhe rritjen e efektshmërisë dhe rentabilitetit;
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e mjeteve në kushte optimale pune;
- Zhvillon dhe propozon raporte për drejtuesit e lartë lidhur me flotën e mjeteve dhe aktivitetet nën përgjegjësinë e tij;
- Përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparim në kohë të makinave, si dhe menaxhimin e kostove;
- Përgatit vlerësime të detajuara të sasive dhe kostot e materialeve dhe punës së nevojshme, sipas specifikimeve të dhëna;
- Monitoron aspektet teknike për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave dhe mekanizmeve mekanike, objekteve dhe komponentëve, për të siguruar performancë të kënaqshme dhe pajtueshmërinë me specifikimet dhe rregulloret;
- Zhvillon dhe monitoron zbatimin e standardeve të sigurisë dhe të procedurave të punës;
- Siguron që pajisjet e punës të jenë në përputhje me specifikimet e projektit dhe me standardet e sigurisë;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Mban dokumentacionin e nevojshëm mbi secilin mjet, problemet teknike dhe organizative për punën e bërë.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Diplomë në Inxhinieri Mekanike;**
- **Eksperiencë e meparshme në pozicione të ngjashme në Industrinë e Ndërtimit (MUST);**
- Njohës i proceseve operacionale, planifikimit dhe menaxhimit strategjik të logjistikës, magazinës, transportit dhe inventarizimit;
- Aftësi analitike, planifikimi dhe menaxhimi;
- Aftësi komunikimi, shitëse dhe negociuse;
- Zotërim i gjuhës angleze.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.